



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 869/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e Hamdi Kamberi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër komisionarëve të QV në Klinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Hamdi Kamberi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Anr.869/2013, dhe Anr.870/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 14.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr.869/2013 dhe Anr.870/2013, nga Hamdi Kamberi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me të cilat pretendohet se gjatë ditës së votimit ka pasur parregullsi të natyrave të ndryshme si manipulim të votave.

- Sipas ankesës Anr 869/2013, Hamdi Kamberi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë, pretendon se komisionarët e Vendvotimit 0801c/06R nuk i kanë evidentuar-shënuar votat e dhëna nga votuesit. Pretenduesi i ankesës thekson se është i sigurt që në këtë vendvotim i ka pas tetë (8) vota dhe për këtë dëshmon edhe anëtari i komisionit nga LDK Lavdim Dushi i cili dëshmon se gjatë procesit i ka lexuar tetë(8)vota, kurse në FPR nuk janë evidentuar.
- Sipas ankesës Anr 870/2013, Parashtruesi i ankesës pretendon se në Qendrën e Votimit nr. 0808c në Gllarevë në VV. 0808c/03 nga anëtarët e këshillit të Vendvotimeve të lartcekura kanë bërë shkelje duke mos ia evidentuar votat e fituara. Po ashtu parashtruesi i ankesës thotë se ka dëshmi nga votuesit të cilët dëshmojnë se kanë votuar për atë. Sipas pretenduesit të ankesës shifra e votave të dyshuara është rreth 70 vota gjë që ndikon në rezultatin e votave dhe që është dëmtuar shumë.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se.

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet e Hamdi Kamberi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë nga subjekti politik LDK, janë të pabazuara ngase më shkresat e ofruar si dëshmi nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar se në çfarë kohe ka ndodhur shkelja në fjalë, siç pretendohet dhe që kërkohet me nenin 3.6.b të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Me nenin 105.1 të LZP-së përcaktohet se për të gjitha parregullësit për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), mund të parashtrahet ankesë në PZAP brenda 24 orëve nga momenti i shkeljes së supozuar, që në rastin konkret nuk është specifikuar nga pala kur ka ndodhur shkelja. Andaj bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 869/2013 më datën 15.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.